



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 17, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, të nenit 2 të Ligjit nr. 03/L - 215, mbi qasjen në dokumente publike dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika c të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391 të dt. 25.2.2014, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2014 miratoi këtë

R R E G U L L O R E
PËR HAPJEN E KUTIVE TË ANKESAVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat për hapjen e kutive të ankesave, shqyrtimin e ankesave, sugjerimeve, rekomandimeve dhe komenteve të parashtrura nga qytetarët.

2. Fushëveprimi

Neni 2.

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje përcaktohen: vendosja e kutive, hapja e kutive, shqyrtimi i shkresave, formimi i komisionit për hapjen e kutive të ankesave, pranimi i sugjerimeve, rekomandimeve dhe komenteve që kanë të bëjnë me të punësuarit në Komunë, duke u bazuar në rregullativën në fuqi.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

1. Vendvendosja e kutive të ankesave

Neni 3.

3.1. Kutitë e ankesave vendosen në hyrje të institucioneve publike, në vend të hapur, ku mund të vërehen nga qytetarët.

3.2 Drejtoria kompetente për Administratë është e obliguar që të përkujdeset për vendosjen e kutive të ankesave dhe mirëmbajtjen e tyre.

3.3 Përzgjedhja e operatorit për punimin e kutive të ankesave bëhet përmes Departamentit të prokurimit.

2. Komisioni për hapjen e kutive të ankesave

Neni 4.

4.1. Drejtori i Drejtorisë kompetente për Administratë e emëron komisioni për hapjen e kutive të ankesave.

4.2. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë me mandat një (1) vjeçar. Tre (3) anëtarë të komisionit janë shërbyes civilë, një (1) anëtar caktohet nga Kuvendi i Komunës dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile, i cili nuk duhet të jetë anëtar i ndonjë komiteti ose këshilli të Komunës.

4.3. Me rastin e caktimit të anëtarëve të komisionit, duhet pasur parasysh edhe përfaqësimin gjinor.

3. Procedura për hapjen e kutive të ankesave

Neni 5.

5.1. Hapja e kutive të ankesave bëhet çdo të premte të fundit të muajit. Në rast se ajo ditë bie ditë pushimi, atëher procedura e hapjes së kutive bëhet në ditën e parë të punës që pason.

5.2. Komisioni bënë ndarjen e ankesave (shkresat) në bazë të objektit të ankesës për drejtoritë përkatëse.

5.3. Çdo shkresë (ankesë, sugjerim, vërejtje) iu dorëzohet drejtorëve të drejtorive përkatëse, e nënshkruar nga drejtori i Drejtorisë kompetente për Administratë, brenda afatit prej shtatë (7) ditëve të punës nga dita e hapjes së kutive.

5.4. Në rast se shkresat (ankesa, sugjerimi, vërejtja), janë anonime, kryesuesi i komisionit është i obliguar të japë përgjigje të cilën e publikon në tabelën e shpalljeve të Komunës.

5.5. Komisioni për hapjen e kutive të ankesave duhet t'i raportojë drejtorit të Drejtorisë kompetente për Administratë, pas çdo procedure të hapjes së kutive, duke mbrojtur anonimitetin e personave të përfshirë.

5.6. Çelësat e kutive të ankesave i mban drejtori i Drejtorisë kompetente për Administratë.

Neni 6.

Qytetarët mund të ankohen:

6.1. kundër vendimeve të organeve të Komunës;

6.2. për shërbimet jo të mira;

6.3. për refuzimin e shërbimeve;

- 6.4. për heshtjen në marrjen e vendimeve (heshtje administrative);
- 6.5. për sjelljet e punonjësve;
- 6.6. për shkeljen ose cenimin e të drejtave të tyre.

Neni 7.

- 7.1. Komisioni, në afat prej tre (3) ditësh është i obliguar që të hartojë raportin për numrin e ankesave dhe natyrën e tyre, dhe atë t'ia dorëzojë drejtorit të Drejtorisë kompetente për Administratë;
- 7.2. Komisioni pas shqyrtimit të ankesave, sugjerimeve ose vërejtjeve, obligohet që në afat ligjor t'i ktheje përgjigje me shkrim palës.
- 7.3. Pas pranimit të raportit nga komisioni, drejtori i Drejtorisë kompetente për Administratë obligohet që të veprojë konform paragrafit 5.3 të nenit 5 të kësaj rregulloreje;
- 7.4. Ankesa ndaj përgjegjjes duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti kur qytetari konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij;
- 7.5. Asnjë vendim administrativ nuk mund të ndërmerret në dëm të parashtruesit të ankesës, si pasojë e parashtrimit të ankesës;
- 7.6. Bazuar në Ligjin për përdorimin e gjuhëve, qytetari mund ta plotësojë formularin në gjuhën zyrtare, të paraparë sipas nenit 13 të Statutit të Komunës së Prishtinës.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8.

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdesen organet e Administratës së Komunës.

Neni 9.

Kjo rregullore hyn në fuqi në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e publikimit të saj në tabelën e shpalljeve dhe në web - faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 031 - 249296, më 30.10.2014

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.